Republika e Kosovës-
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada – Government

Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve
Nacionalni Autoritet za Kvalifikacije
National Qualification Authority

Numër: 530/13
Datë: 24.05.2013

Në mbështetje të neneve 6 dhe 16 të Ligjit nr. 03/L-060 mbi Kualifikimet Kombëtare të datës 7 nëntor 2008 dhe Udhëzimit Administrativ nr. 1/2011- Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë me nenet 4,7,10 dhe 16, Këshilli Drejtues i Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve me datë 24.05.2013 nxjerr këtë:

VENDIM

1. QAP "English Centre", me dy degë/qendra në Prishtinë, duhet plotësuar kushtet deri në afatin e caktuar (gjashtë muaj nga nxjerrja e këtij vendimi), për të marr akreditim institucional.

Kushtet:

- Duhet siguruar trajnimi i zyrtarit për sigurimin e cilësisë;
- Dokumentacioni i plotë lidhur me politikat, procedurat, normat dhe rregullat për sigurimin e cilësisë;
- Trajnime për atë se çka kërkohet gjatë procesit të akreditimit;
- Paraqitja e planeve 5-vjeçare të zhvillimit, AKK-së (prej vitit 2013 e tutje);
- Përkufizimi dhe identifikimi i vlerësimit të jashtëm për kurset e gjuhës angleze;

- Të ofrojë dëshmi të një politike për zhvillimin e stafit në lidhje me shkathtësitë e mësimdhënies që bazohet në Udhëzimet e AKK-së dhe sistemet efektive për zbatimin e kësaj politike në të dy qendrat Q1 dhe Q2.

2. Arsyetim

Në bazë të kërkesës së institucionit/ofruesit, me datë: 24.05.2013, Këshilli Drejtues i AKK-së merr këtë vendim bazuar në rekomandimet të dala nga Raporti i Vlerësimit të Panelit të ekspertëve mbi Akreditimin e Institucionit i cili ofron dhe/ose vlerëson dhe lëshon kurse të gjuhës angleze dhe këto rekomandime janë të mbështetura në fakte dhe dokumente si në vijim:

- Aplikacioni për Akreditim si Institucionit Ofrues dhe/ose Vlerësues dhe Lëshues të Kualifikimit;
- Raporti i Vetë-vlerësimit;
- Vizita në institucionin/ofruesin aplikues, dhe
- Dokumente tjera shtesë.

2.1. Pala e pakënaqur me vendimin, ka drejtë ankese në organet e shkallës së dytë. Ankesa bëhet përmes organit të shkallës së parë.

2.2. Kushtet e parashtruara për aprovim dhe akreditim duhet të përmbushen në afatin e caktuar nga AKK.

3. AKK mbledh panelin vlerësues për verifikimin e kushteve të caktuara nga ky vendim.

3.1. Në bazë të rezultateve dhe rekomandimeve të dala nga vizita e eksperteve, KD i AKK-së do të marr vendimin për akreditim ose mos akreditim.

3.2. Institucionit QAP "English Centre" – Prishtinë obligohet që të marr mbi vete shpenzimet për ekspert (një ditë pune sipas UA nr.1/2011), Institucioni është i liruar nga pagesat tjera administrative.

4. Vendimi hyn në fuqi me datën e nënshkrimit të tij.

5. Vendimi u dërgohet:

- QAP "English Centre" – Prishtinë;
- AKK-së.

Kryetari i KD së AKK-së
Ragip Gjoshi